

Programi



PS

i Partisë Socialiste
të Shqipërisë

2024-2030



Programi i Partisë Socialiste të Shqipërisë 2024-2030



Të dedikohet Ty
si qytetar i
këtij vendi



PARATHENIE

Të dashur bashkëqytetarë,

Kur historia do të shkruajë kapitullin e tashëm të Shqipërisë, do të flasë për një komb që diti të marrë vendimin e duhur historik. Para nesh qëndron një shans unik që Shqipëria nuk e ka pasur kurrë më parë: mundësia që brenda kësaj dekade të bëhemi anëtarë me të drejta të plota të Bashkimit Europian.

Zgjedhjet e 11 majit 2025 nuk janë thjesht një tjetër stacion i zakonshëm elektoral, por një moment vendimtar për fatin e vendit dhe fëmijëve tanë - një prag i rëndësishëm ku përmbillet i gjithë rrugëtimi ynë i gjatë drejt familjes europiane.

Transformimi i Shqipërisë flet përmes shifrave që nuk gënjejnë: të ardhurat për frymë janë trefishuar, paga mesatare është rritur 2.6 herë dhe paga minimale është dyfishuar që nga viti 2013. Prodhimi i Brendshëm Bruto ka arritur në 25 miliardë euro, ndërsa eksportet janë trefishuar - dëshmi e një ekonomie që po lulëzon përmes reformave transformuese në arsim, energji, shëndetësi dhe riorganizim territorial.

Shqipëria ka forcuar rolin e saj ndërkombëtar duke kryesuar OSBE-në, ulur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së si bashkëshkruese me SHBA-të, si dhe anëtare në Këshillin e të Drejtave të Njeriut të UNESCO, duke e ngritur flamurin tonë më lart se kurrë më parë. Digjitalizimi i administratës ka eliminuar ryshfetet, radhët e stërzgjatura dhe harxhimin e panevojshëm të kohës. Sot, shqiptarët marrin pothuajse çdo shërbim online, duke kursyer qindra milionë euro dhe duke garantuar cilësi e shpejtësi me transparencë maksimale.

Por reforma më transformuese mbetet Reforma në Drejtësi - një testament i vullnetit të palëkundur të Partisë Socialiste dhe mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë për një Shqipëri ku ligji është i barabartë për të gjithë.

Me anëtarësimin në BE, pasaporta shqiptare do të mbajë simbolin e Bashkimit European, duke garantuar lëvizje të lirë pa radhë e pa kontrolle, ndërsa qytetarët tanë do të gëzojnë status të barabartë në të gjithë Europën me mundësi të njëjta jetese, punësimi, investimi dhe edukimi.

Anëtarësimi në BE është një dritare që nuk do të rrijë gjithmonë hapur. Në këtë moment kritik, duhet të vendosim: do ta përmbyllim me sukses këtë udhëtim historik apo do ta humbim këtë mundësi? Vetëm vota për Partinë Socialiste është garanci për vazhdimësinë e rrugëtimit european. Me 12 maj duhet t'i dërgojmë Brukselit mesazhin e qartë: Shqipëria vazhdon përpara, pa kthim prapa.

Së bashku mund ta bëjmë Shqipërinë anëtare të Bashkimit European brenda viti 2030. Ky është shansi i brezit tonë për të shënuar pikë kthese në historinë kombëtare. Le ta kapim me të dyja duart.

Faleminderit për secilin hap, për çdo ndihmë, për çdo ideal të ndarë. Vetëm së bashku do të nderojmë sakrificën e çdo shqiptari që deshi, luftoi dhe punoi për një atdhe me dinjitet e mirëqenie, ashtu siç e meriton populli ynë.

Na priftë e mbara!



Kryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë

①

Shqipëria Europiane

Ëndrra europiane e shqiptarëve është më afër se kurrë. Shqipëria do të ulet me të drejta të plota në tryezën e Bashkimit European, duke ndarë vendimmarrjen mbi politikat e unionit dhe duke kontribuar në vlerat e demokracisë, paqes dhe sigurisë. Anëtarësimi sjell akses në tregun e përbashkët, mundësi të barabarta në politikat e BE-së dhe standarde të njëjta jetese për qytetarët tanë.

1.1 Shqipëria vend anëtar i Bashkimit European

Ëndrra europiane e shqiptarëve është më afër se kurrë. Shqipëria do të ulet me të drejta të plota në tryezën e Bashkimit European, duke ndarë vendimmarrjen mbi politikat e unionit dhe duke kontribuar në vlerat e demokracisë, paqes dhe sigurisë. Anëtarësimi sjell akses në tregun e përbashkët, mundësi të barabarta në politikat e BE-së dhe standarde të njëjta jetese për qytetarët tanë.

Cfarë bëjmë që bashku?

Morëm statusin e vendit kandidat në 2014, pas përmbushjes së reformave kyçe në administratë publike, drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe respektimin e të drejtave themelore. Vijuam përparimin në të gjitha prioritetet dhe në mars 2020 siguroam hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Hapëm negociatat faktike përmes dy konferencave ndërqeveritare (15 tetor dhe 17 dhjetor 2024), duke shënuar një hap konkret drejt anëtarësimit në BE.

Kthyem Shqipërinë në vendin që hapi rrugën për Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor, duke organizuar takimin e liderëve evropianë në Tiranë në shkurt 2024. Dorëzuam dhe miratuam Agjendën Kombëtare për Reformat dhe Rritjen në tetor 2024, duke siguruar 922.1 milionë euro në grante dhe kredi të favorshme, të cilat do aktivizohen me përmbushjen e reformave të dakorduara.

Forcuam partneritetin me BE-në në siguri dhe mbrojtje, duke nënshkruar Partneritetin për Sigurinë dhe Mbrojtjen në dhjetor 2024. U bëmë anëtarë të Qendrës Evropiane të Ekselencës Kundër Kërcënimeve Hibrde (Hybrid CoE) në Helsinki, duke konsoliduar rolin tonë si kontribues në sigurinë rajonale dhe evropiane.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Fokusohemi në përmbushjen e plotë të kriterëve të anëtarësimit, duke vijuar me reformat për përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit. Hapim të gjithë grup-kapitujt deri në fund të 2025 dhe i mbyllim brenda 2027, me synimin për anëtarësim të plotë deri në fund të dekadës.

Integrojmë inteligjencën artificiale për të përshpejtuar përafrimin e legjislacionit kombëtar dhe fuqizojmë administratën publike për të përballuar intensitetin e negociatave. Risim përfaqësimin e Shqipërisë si anëtar apo vëzhgues në institucionet e BE-së, duke zgjeruar praninë tonë, ashtu si kemi nisur duke u bërë pjesë e 1/3 e tyre.

Forcojmë partneritetin me biznesin dhe aktorët e shoqërisë, duke përgatitur Shqipërinë për kërkesat dhe mundësitë e tregut të përbashkët evropian. Me veprime konkrete dhe rezultate të matshme, e sjellim Europën në Shqipëri, ndërsa flamuri ynë kombëtar do të valvitet krahas 27 flamujve të vendeve anëtare të BE-së.

Risim përthithjen e fondeve të Bashkimit European për Shqipërinë në 1 miliard euro çdo vit.

1.2 Administratë smart dhe me integritet

Modernizuar administratën publike me një qasje të qëndrueshme dhe efikase. Zgjeruam digjitalizimin e shërbimeve publike, forcuam transparencën dhe llogaridhënien dhe konsoliduam arkitekturën institucionale për zbatimin dhe avancimin e politikave antikorrupsion.

Cfarë bëme që bashku?

Transformuam ofrimin e shërbimeve publike përmes revolucionit digjital.

Nga vetëm 15 shërbime online në 2013 me 50 mijë përdorues, kaluam në 1,252 shërbime, që përbëjnë 95% të totalit të shërbimeve publike, të aksesueshme online nga 3.1 milion përdorues.

Eliminuam sportelet, duke kaluar nga dokumentet fizike te vulat dhe firmat elektronike, duke kursyer 620 milionë euro.

Transformuam pagat në administratën publike, duke e rritur pagën mesatare në mbi 900 euro, një rritje historike prej 45% krahasuar me më parë. Vendosëm detyrimin ligjor për indeksimin e pagave të paktën një herë në dy vjet, duke garantuar një standard jetese dinjitoz për punonjësit.

Forcuam standardet e integritetit, me fokus prokurimet publike, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe ulur korrupsionin. Procedurat me negociim pa shpallje nga 41% në 2013, sot janë reduktuar në 2.2%. Rritëm kursimet publike, duke rritur diferencën mes fondit limit dhe fondit fitues nga 7% në 2013 në 15% sot.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Rrisim aksesin dhe cilësinë e shërbimeve publike (IA, Diella, Omnichannel dhe Infopoints) duke siguruar një ndërveprim më të shpejtë dhe efikas me qytetarët.

Thellojmë bashkëpunimin midis pushtetit qendror dhe atij vendor, duke e vendosur në qendër të agjendës sonë reformuese avancimin e decentralizimit dhe reformën territoriale. Synimi ynë është fuqizimi i bashkive si agjentë të zhvillimit ekonomik dhe garantimi i një qeverisjeje vendore më efektive dhe të përgjegjshme.

1.3 Sundimi i Ligjit dhe Lufta Kundër Korrupsionit

Reforma në Drejtësi ka qenë dhe mbetet një shtyllë kryesore e qeverisjes sonë, e iniciuar si prioritet para vitit 2013 dhe e realizuar përmes një procesi të thellë transformimi, me mbështetjen e BE-së dhe SHBA-së. Ky ndryshim ka konsoliduar pavarësinë e institucioneve të drejtësisë, ka forcuar transparencën dhe llogaridhënien, duke e bërë sistemin më efikas dhe të besueshëm.

Lufta kundër korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë është e pakthyeshme, duke garantuar që drejtësia të mos jetë privilegj i pakicës, por e drejtë e çdo qytetari. Ndërtimi i një drejtësie të aftë për të çrrënjosur korrupsionin ka shkuar paralelisht me reduktimin e kontaktit të drejtpërdrejtë mes qytetarëve dhe administratës publike, duke minimizuar hapësirat për abuzim.

Cfarë bëjmë së bashku?

Nëpërmjet Reformës në Drejtësi, ngritëm për herë të parë një mekanizëm të plotë vettingu, duke pastruar sistemin nga individët e papërshtatshëm.

Krijuam institucione të reja për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si SPAK, GJKKO dhe BKH, duke siguruar një gjyqësor të pavarur dhe efikas.

Miratuam hartën e re gjyqësore dhe mbështetëm financiarisht institucionet e drejtësisë për të garantuar funksionalitetin e tyre.

Vendosëm një sistem pagash konkurrues për punonjësit e drejtësisë, duke rritur pagat me mbi 25% në të gjitha kategoritë dhe mbi 100% për prokurorët e SPAK.

U bëmë i vetmi vend në rajon me marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha agjencitë e drejtësisë dhe ministritë e punëve të brendshme të BE-së.

Digjitalizuar shërbimet publike, duke ndërprerë zinxhirët korruptivë në ofrimin e tyre dhe duke minimizuar kontaktin e drejtpërdrejtë mes qytetarëve dhe administratës publike. Krijua mjet të drejtpërdrejtë komunikimi digjital për qytetarët në denoncimin e rasteve të dyshuara abuzive dhe korruptive, përmes Platformës së Bashkëqeverisjes.

Kemi kryer 270 mijë legalizime që nga marrja e detyrës, krahasuar me 21,750 legalizime deri në 2013-ën.

Çfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Vazhdojmë të mbështesim Reformën në Drejtësi duke garantuar funksionimin e institucioneve të reja mbi bazën e standardave ndërkombëtare dhe forcimin e përgjegjësisë institucionale.

Përfundojmë digjitalizimin e plotë të sistemit të drejtësisë si dhe investimet në sisteme të avancuara në fushën e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Vëmë në funksion Institutin e të Miturve në konflikt me ligjin, me një investim prej 20 milionë euro, si pjesë e angazhimit tonë për një drejtësi miqësore ndaj fëmijëve.

Integrojmë Inteligjencën Artificiale në prokurimet publike, duke eliminuar korrupsionin dhe abuzimet në tendera, ashtu si "e-Albania" eliminoi sportelet dhe radhët.

Reformojmë të gjitha strukturat inspektuese me standardet e BE-së për të siguruar një treg funksional, duke ulur barën administrative dhe mbrojtur konsumatorët.

Brenda vitit 2026 përfundojmë digjitalizimin e kadastrës, dhe deri në 2028 mbyllim përfundimisht regjistrimin e pronave dhe procesin e legalizimeve, që çdo qytetar të ketë në dorë certifikatën e pronës.

Zbatojmë një amnisti periodike për gratë dhe të miturit nga viti i ardhshëm, duke lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

Shtrijmë këshillimin ligjor falas në çdo bashki, duke siguruar akses të barabartë dhe mbrojtje efektive për qytetarët.

1.4 Politika e Jashtme dhe Diplomacia Aktive e Shqipërisë

Politika e jashtme e Shqipërisë udhëhiqet nga një vizion strategjik i qartë, i orientuar drejt sigurisë, stabilitetit dhe integritetit evropian. Aleanca me SHBA-në mbetet e patjetërsueshme, ndërsa si vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për BE-në, Shqipëria vijon të konsolidojë rolin e saj në skenën ndërkombëtare.

Në fokus është diplomacia aktive për zhvillim të qëndrueshëm, forcimin e integritetit rajonal dhe avancimin e interesave kombëtare.

Çfarë bëjnë gjë bashku?

Shqipëria ka forcuar rolin e saj global duke kryesuar OSBE-në, ulur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së si bashkëshkruese me SHBA-të, anëtare në Këshillin e të Drejtave të Njeriut dhe UNESCO, si dhe duke dalë nga monitorimi i Këshillit të Evropës, duke dëshmuar angazhimin për paqen, sigurinë dhe demokracinë.

Përmes një diplomacie aktive, Shqipëria ka zgjeruar praninë ndërkombëtare, duke forcuar rolin në NATO, hapur tetë përfaqësi të reja dhe dixhitalizuar shërbimet konsullore përmes e-Albania, duke rritur aksesin dhe efikasitetin për qytetarët.

Kemi sjellë 52 shërbime online për diasporën, kemi hapur dyert e 126 vendeve pa viza për shqiptarët dhe kemi nënshkruar marrëveshje që patentat shqiptare të njihen në 11 shtete, për t'ua bërë jetën më të lehtë bashkëkombësve tanë kudo që janë.

Luajtëm një rol kryesor në nismat rajonale, duke përmbushur me profesionalizëm angazhimet tona. Shqipëria ka kryesuar katër presidenca të rëndësishme rajonale.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Thellojmë Partneritetin Strategjik me Kosovën duke avancuar bashkëpunimin diplomatik dhe zhvillimin e qëndrueshëm në rajon.

Intensifikojmë përfaqësimin në organizatat ndërkombëtare dhe diplomacinë ekonomike për të rritur ndikimin e Shqipërisë në politikat e BE-së dhe NATO-s. Shqipëria do të përforcojë rolin e saj si aktor kyç në sigurinë dhe zhvillimin rajonal duke pritur në 2025 Samitin e Komunitetit Politik Evropian dhe në 2027 Samitin e NATO-s për Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Tiranë.

Orientojmë diplomacinë ekonomike drejt nxitjes së investimeve dhe tregtisë, duke mbështetur sektorë kyç si turizmi, bujqësia dhe industria.

Risim bashkëpunimin në arsim dhe kërkimin shkencor, duke fuqizuar lidhjet mes të rinjve të Ballkanit dhe krijuar aftësi të përbashkëta për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.

Intensifikojmë marrëdhëniet me diasporën, duke e shndërruar atë në një forcë zhvillimi për Shqipërinë.

1.5 Siguria Kombëtare dhe Mbrojtja

Mbrojtja nuk është më një sektor i neglizhuar, por një shtyllë strategjike që forcon interesat kombëtare, mbështet ekonominë dhe e bën Shqipërinë një faktor stabiliteti dhe sigurie në rajon.

Cfarë bëjmë së bashku?

Rritëm buxhetin e Mbrojtjes nga 28 milionë euro në 280 milionë euro, duke e dhjetëfishuar dhe forcuar kapacitetet tona mbrojtëse.

Prej dy vitesh respektojmë zotimin e NATO-s, për 2% e PBB kushtuar mbrojtjes.

Rritëm ndjeshëm pagat për të gjitha kategoritë e Forcave të Armatosura duke çuar pagën mesatare në 1,550 euro në muaj për ta renditur Shqipërinë në krye të tabelës rajonale dhe vendosëm meritokracinë si orientim për zhvillimin e karrierës, falë reformës së arsimit të lartë ushtarak duke rritur 5 herë më shumë rekrutime në Forcat e Armatosura.

Modernizuar dhe zgjeruar kapacitetet dhe infrastrukturën kritike me fokus në inovacion dhe teknologji. Sot, flota ajrore me helikopterë Black Hawk, njësia ushtarake kibernetike, Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, baza ajrore taktike e NATO-s në Kuçovë dhe dronët Bayraktar janë realitete të prekshme.

Rijetëzuam industrinë ushtarake si një përparësi kombëtare me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin ekonomik, kërkimin shkencor dhe punësimin cilësor të komuniteteve lokale në Kuçovë dhe më gjerë.

Transformuar mbrojtjen civile me fokus në parandalimin e fatkeqësive dhe koordinimin efektiv të burimeve kombëtare e lokale, duke garantuar reagim të shpejtë ndaj emergjencave. Investimet në teknologji, përfshirë satelitët Albania 1 dhe 2, forcuan qasjen gjithëshetërore dhe rritën qëndrueshmërinë e vendit.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Vazhdojmë mbështetjen financiare për Forcat e Armatosura, duke rritur çdo vit buxhetin mbi normën 2% të PBB-së dhe sigurojmë trajtim financiar më të lartë për efektivët tanë, mbi mesataren e NATO-s.

Fuqizojmë kapacitetet reaguese të Bashkive, duke ngritur qendra rajonale të emergjencave civile për të garantuar siguri dhe ndërhyrje të shpejtë në çdo rast.

Sigurojmë dy avionë zjarrfikës për të fuqizuar flotën ajrore dhe për t'u përballur më mirë me emergjencat natyrore.

Zhvillojmë industrinë ushtarake shqiptare për prodhimin e municioneve, artilerisë, dronëve dhe mjeteve të blinduara, duke kthyer vendin në një qendër të fuqishme të prodhimit ushtarak në rajon.

Rilindim shkollën e aviacionit në Vlorë, për të ndërtuar një brez të ri pilotësh dhe specialistësh të mbrojtjes ajrore.

Përfundojmë kampusin modern të Akademisë së Forcave të Armatosura deri në vitin 2028, duke garantuar kushte të standardeve më të larta për formimin e trupës ushtarake.

Sigurojmë prodhimi e tre anijeve të reja luftarake në Shqipëri, për të rritur kapacitetet detare dhe aftësitë mbrojtëse të vendit.

②

Rritja Ekonomike e Qëndrueshme – Themelet e Shqipërisë së Ardhshme

Rritja ekonomike nuk ka vlerë nëse nuk mbështet çdo qytetar. Vizioni ynë bazohet në drejtësi sociale dhe gjithëpërfshirje, duke siguruar që zhvillimi të mos mbetet vetëm në shifra, por të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë, nga qytetet tek fshatrat më të largët.

2.1 Drejt një Ekonomie më Konkurruese dhe të Qëndrueshme

Cfarë bëjmë që bashku?

Rritëm prodhimin e brendshëm bruto mbi 2.5 herë, nga 9.6 miliardë euro në 2013 në 25 miliardë euro sot, duke sjellë më shumë ekonomi, më shumë vende pune dhe më shumë mirëqenie për shqiptarët.

Të ardhurat për frymë janë trefishuar, nga 3,324 euro në 2013 në 10,342 euro në 2024, një dëshmi e një zhvillimi real që ndihet në çdo familje dhe që ka ndryshuar rrënjësisht standartin e jetesës.

Ulëm shkallën e papunësisë nga 17.5% në 8.8%, dhe papunësinë rinore nga 31.4% në 19.1%.

Rritëm pagën mesatare nga 322 euro në 830 euro dhe pagën minimale nga 157 euro në 400 euro, duke dyfishuar të ardhurat e qytetarëve dhe përmirësuar jetesën e çdo familjeje shqiptare.

Borxhi publik është ulur ndjeshëm nga 70.4% e PBB-së në 54.7%, duke krijuar hapësira më të mëdha fiskale për investime strategjike dhe duke kursyer çdo vit rreth 300 milionë euro për buxhetin e shtetit.

Trefishuam eksportet duke i çuar nga 2.8 miliardë euro në 2013, në 8.4 miliardë euro sot.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Risim të ardhurat për çdo qytetar me 40%, duke i çuar në 14,157 euro për frymë deri në vitin 2030.

Çojmë pagën mesatare në 1,000 euro dhe pagën në administratë në 1,200 euro.

Risim pagën minimale në 500 euro deri në 2026, duke garantuar 18 muaj pa asnjë taksë shtesë.

Zgjerojmë madhësinë e ekonomisë në 33 miliardë euro deri në fund të mandatit të katërt.

2.2 Mbështetje për biznesin

Cfarë bërmë je bashku?

Rritëm pragun e TVSH-së në nivelin më të lartë në rajon, duke përjashtuar shumicën e bizneseve të vogla nga kjo detyrë. Sot, vetëm 27% e bizneseve janë subjekt i TVSH-së, ndërsa pjesa tjetër përfitojnë nga politika lehtësuese.

Eliminuar tatimin për bizneset me xhiro deri në 14 milionë lekë, duke përjashtuar 90% të bizneseve të vogla nga tatimi mbi të ardhurat dhe duke lehtësuar 17 miliardë lekë në vit për sipërmarrjen.

Hymë në SEPA, duke ulur kostot e pagesave ndërkombëtare, përshpejtuar transaksionet me tregjet e BE-së dhe lehtësuar qasjen e biznesit shqiptar në ekonominë europiane.

Digjitalizuar shërbimet, duke mundësuar aplikime për leje, licenca dhe dokumente pa burokraci, duke kursyer kohë dhe kosto për bizneset.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Mobilizojmë mbi 2 miliardë euro kredi dhe garanci për bizneset, përmes Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Zhvillimit, për të rritur investimet dhe prodhimin vendas.

Iniciojmë 1 miliardë euro investime të reja përmes paketës Smart Albania, për të nxitur inovacionin dhe teknologjinë.

Gjenerojmë mbi 8 miliardë euro të reja në ekonomi dhe hapim 100 mijë vende pune.

Me Paketën e Maleve mundësojmë marrjen e lejes së investimit për poseduesit e tokave mbi 10 vite me vetëm 1 euro. Ofrojmë taksë zero dhe TVSH zero për 10 vitet e para, për 500 sipërmarrësit e parë përfitues.

Vendosim marrëveshje 3-vjeçare për paqe fiskale me biznesin, me taksë 15% mbi fitimin normal dhe vetëm 5% për fitimin shtesë.

Kalojmë tek rimbursimi automatik i TVSH-së pa kontrolle fizike, falë sistemit të ri dixhital të fiskalizimit, ndërsa kontrollet i bëjmë më të pakta dhe më cilësore, duke lehtësuar ndjeshëm biznesin.

Heqim çmimet e referencës për importet nga BE-ja, për të lehtësuar tregtinë dhe ulur kostot për bizneset.

2.3 Puna dhe kapitali njerëzor - Themel i zhvillimit dhe mirëqenies

Tregu i punës është në një motor zhvillimi dhe mirëqenieje për çdo qytetar. Në një dekadë, kemi sjellë ndryshime thelbësore në punësim, duke garantuar më shumë vende pune, paga më të larta dhe një treg më dinamik e gjithëpërfshirës.

Cfarë bërmë jë bashku?

Papunësia është ulur në nivele historike. Nga një shkallë papunësie prej 17,5% në 2014, sot ka arritur në 8,8% në 2024, me mbi 300,000 vende të reja pune, duke zgjeruar tregun për të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël.

Fuqia blerëse dhe pagat janë rritur ndjeshëm. Paga minimale është dyfishuar, duke siguruar stabilitet ekonomik për familjet shqiptare, ndërsa paga mesatare në sektorin publik është rritur duke garantuar vlerësim real për çdo punonjës.

Shërbimet e punësimit janë modernizuar duke ndërtuar një treg të hapur dhe të lehtë për qytetarët. Shqipëria është renditur e para në Ballkanin Perëndimor për politikat e punësimit sipas OECD.

Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Punësimit ka krijuar lidhje të drejtpërdrejta mes qytetarëve dhe biznesit, duke eliminuar burokracinë dhe lehtësuar aplikimet për punë.

Fuqizuar mbështetjen për të rinjtë me Garancinë Rinore, duke garantuar punësim, trajnim dhe edukim për çdo të ri brenda katër muajve.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Transformojmë përmes digjitalizimit shërbimet e punësimit, me një sistem të zgjuar për orientimin e karrierës dhe një platformë të veçantë për emigrantët që duan të rikthehen e të punojnë në Shqipëri.

Konsolidojmë politikat për punësimin e të rinjve dhe grave, përmes zgjerimit të Garancisë Rinore dhe përmirësimit të politikave të barazisë në paga.

Thellojmë bashkëpunimin me sektorin privat, duke zgjeruar modelin dual të arsimit profesional dhe rritur kualifikimet me certifikim ndërkombëtar.

Themelojmë Fondin Kombëtar të Aftësisë për të financuar zhvillimin dhe riaftësimin e forcës së punës. Ndhmojmë punonjësit të kalojnë në sektorë me vlerë më të lartë, duke garantuar aftësi të reja për një treg pune dinamik.

2.4 Infrastruktura Moderne – Shtylla e Zhvillimit Ekonomik dhe Konkurrueshmërisë

Infrastruktura moderne është themeli mbi të cilin ndërtohet një ekonomi konkurruese dhe e qëndrueshme. Pa rrugë, porte, aeroporte dhe hekurdhua me standarde, transport efikas dhe lidhje të shpejta dixhitale, as bizneset nuk mund të rriten, as turizmi nuk mund të lulëzojë, as ekonomia nuk mund të ecë përpara.

Cfarë bëme që bashku?

Transformuam rrënjësisht infrastrukturën e vendit, duke ndërtuar 935 km rrugë, 21 km ura dhe 12 km tunele. Përmbyllëm projektet strategjike si Rruga e Kombit, Rruga e Arbrit dhe rruga Shkodër-Theth, duke lidhur Shqipërinë e Mesme me Veriun dhe Veri-Lindjen, e duke i dhënë zhvillim zonave të thella.

Investuam në Korridorin 8 dhe Korridorin Blu, duke ndërlidhur Shqipërinë me rajonin dhe rrjetet transeuropiane të infrastrukturës, duke e kthyer vendin në një nyje strategjike të transportit.

Koha e udhëtimit është përgjysmuar, ndërsa vlera e pronës është rritur me 50%, duke e bërë infrastrukturën motor të zhvillimit ekonomik e social.

Kapacitetet e Aeroportit të Tiranës janë trefishuar, duke rritur numrin e pasagjerëve nga 1.7 milionë në 11 milionë dhe aksesin në fluturime nga 6.7% në 32%. Aeroporti i Kukësit dhe ai i Vlorës, që inaugurojmë së shpejti, hap një epokë të re për lidhjet ajrore të Shqipërisë.

Porti i Durrësit po shndërrohet në një nga portet më të mëdha turistike të Mesdheut, ndërsa Porto Romano po merr rolin e një nyje strategjike për tregtinë.

Transporti hekurudhor po rilind me projektet Tiranë-Durrës-Rinas, Vorë-Hani i Hotit dhe Durrës-Prishtinë, duke integruar Shqipërinë më ngushtë me rajonin.

Investimet në infrastrukturën broadband kanë zgjeruar infrastrukturën dixhitale, duke e bërë Shqipërinë më të lidhur dhe më konkurruese në epokën digjitale.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Ndërtojmë 700 km rrugë të reja dhe vëmë në funksion Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Trafikut deri në 2025, për një lëvizshmëri më të sigurt e më efikase.

Përfundojmë Korridorin Adriatiko-Jonian dhe Korridorin VIII, duke lidhur Shqipërinë me vendet e rajonit për të shndërruar vendin në një nyje strategjike tregtare dhe turistike.

Rindërtojmë linjat ekzistuese hekurudhore dhe ndërtojmë linjën Durrës-Prishtinë, duke krijuar koridore të reja për mallra dhe pasagjerë.

Përfundojmë portin e ri tregtar të Porto Romanos, ndërkohë që zgjerojmë infrastrukturën portuale me marina turistike në Sarandë, Vlorë dhe Kepin e Rodonit, duke e kthyer Shqipërinë në një qendër detare të Mesdheut.

Investojmë në transport të gjelbër dhe të qëndrueshëm, duke ulur ndotjen dhe rritur eficiencën.

2.5 Turizmi – Shqipëria, një histori suksesi në Mesdhe

Cfarë bëjmë së bashku?

Transformimi i Shqipërisë në një destinacion turistik të njohur është një nga historitë tona më të mëdha të suksesit.

Numri i turistëve është rritur nga 1 milionë në mbi 12 milionë vizitorë në vit, duke kthyer turizmin në një nga shtyllat kryesore të ekonomisë.

Të ardhurat nga turizmi janë rritur nga më pak se 1 miliardë euro në thuajse 5 miliardë euro, duke sjellë më shumë zhvillim dhe punësim në të gjithë vendin.

Nga një sezon 2-3 muor në 2013, sot Shqipëria është një destinacion tërheqës gjatë gjithë vitit. Tuneli i Llogarasë, Rruga Kardhiq-Delvinë dhe përmirësimi i infrastrukturës kanë lehtësuar lëvizjen e turistëve drejt Rivierës dhe zonave të thella.

Turizmi është shtrirë në kohë, territor dhe larmishmëri. Agroturizmi sot numëron mbi 270 njësi; ekoturizmi ka tërhequr mbi 5.5 milionë vizitorë brenda një viti; ndërsa turizmi kulturor ka kapur shifrën e 1 milionë vizitorëve në kala, muze dhe site arkeologjike, duke nxitur zhvillim në çdo cep të Shqipërisë.

Në arenën ndërkombëtare, kemi rritur promovimin e Shqipërisë në panaiet më prestigjioze, si ITB Berlin dhe FITUR Madrid, duke kulmuar me zgjedhjen e Shqipërisë si Vendi i Nderit në ITB Berlin 2025, panairi më i madh i turizmit në botë.

Përmirësimi i ofertës turistike ka sjellë kategorizimin e mbi 2,200 strukturave akomoduese dhe certifikimin e 650 udhërrëfyesve turistikë, duke rritur standardet e shërbimit.

Markat ndërkombëtare të hotelerisë po investojnë në Shqipëri, me 17 hotele me pesë yje të përfunduara ose në proces. Këto investime po rrisin konkurrencën dhe po krijojnë mijëra vende pune, duke forcuar turizmin si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë sonë.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Transformojmë Portin e Durrësit në një qendër moderne turistike për kroçera dhe jahte luksoze dhe ndërtojmë 20 marina të reja nga Velipoja në veri deri në Ksamil në jug, duke e bërë Shqipërinë një nga destinacionet më tërheqëse për turizmin detar.

Tërheqim investime nga markat ndërkombëtare të hotelerisë, duke dyfishuar netqëndrimet turistike dhe gjeneruar mbi 6.6 miliardë euro të ardhura vjetore deri në 2030. Ky bum turistik do të krijojë dyfish më shumë vende pune dhe do të nxisë të rinjtë të zgjedhin turizmin si karrierë.

Zhvillojmë turizmin gjithëvjetor, duke investuar në qendra relaksi dhe turizëm malor në Alpe dhe zona të tjera natyrore, për të ofruar eksperiencë unike për adhuruesit e natyrës dhe sporteve dimërore.

Risim organizimin e eventeve dhe festivaleve ndërkombëtare, duke e kthyer Shqipërinë në një qendër të muzikës, artit dhe traditave që tërheq turistë nga e gjithë bota.

Sigurojmë një raport më të drejtë të administrimit të plazheve në favor të qytetarëve nga viti 2025, duke ofruar më shumë hapësira publike dhe qetësi për pushuesit.

Fuqizojmë turizmin kulturor dhe historik me investime në promovimin e siteve të trashëgimisë dhe dixhitalizimin e kalendarëve kulturorë, duke e bërë Shqipërinë një muze të hapur për vizitorët.

Turizmi të mos jetë thjesht ekonomi, por identitet, imazh dhe histori.

2.6 Bujqësia dhe Ekonomia Blu - Nga mbijetesa drejt zhvillimit modern

Cfarë bëjnë që bashku?

Falë investimit në 400 pika të reja përpunimi dhe grumbullimi, në 2024 eksportet bujqësore janë rritur në 532 milionë euro, duke çuar produktet shqiptare në 80 tregje europiane.

Përmirësuam balancën tregtare, duke e ulur deficitin nga 1:9 në 2013-ën në më pak se 1:3 sot.

Mbështetja financiare për bujqësinë është 5-fishuar, duke arritur në 5.2 miliardë lekë ose 40% të buxhetit të Ministrisë. Përmes skemave të subvencionimit 67,100 fermerë kanë përfituar naftë pa akcizë, teknologji moderne dhe grante, nga vetëm 5,600 në vitin 2013.

Investuam mbi 250 milionë dollarë në sisteme ujitëse, duke rritur sipërfaqen e tokës së ujitur me 120,000 hektarë.

3-fishuam sipërfaqjen e serave duke arritur në 2,116 hektarë në vitin 2024.

Sot, realizohen 1,909 teste të akredituara nga ISUV, duke garantuar standardet e sigurisë për produktet vendase.

Agroturizmi është kthyer në një aset kombëtar, ku për çdo njësi agroturistike janë mbështetur mesatarisht 22 familje dhe 11 hektarë tokë të punuar.

Ekonomia blu po zhvillohet me hapa të shpejtë dhe eksportet e akuakulturës kanë arritur në 140 milionë euro.

Çfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Mbështesim produktet me avantazh konkurrues si frutat, perimet, vajin e ullirit dhe prodhimet e akuakulturës, me synimin për të rritur eksportet bujqësore dhe të peshkimit në 1 miliard euro.

Ndërtojmë 5 qendra moderne për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve të freskëta, duke forcuar industrinë agropërpunuese dhe lidhjen me tregun e brendshëm dhe sektorin e turizmit.

Shtojmë 1,000 hektarë të rinj sera për të zgjeruar prodhimin dhe eksportet gjatë gjithë vitit.

Forcojmë sigurinë ushqimore duke krijuar një sistem të rreptë kontrolli nga ferma tek tryeza nëpërmjet modernizimit të laboratorëve, duke garantuar cilësinë dhe gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore

Ndërtojmë 4 markata moderne të peshkut në Vlorë, Durrës, Shkodër dhe Sarandë, si dhe 9 pika të reja tregtimi, duke mbështetur peshkimin artizanal dhe duke krijuar destinacione turistike për produktet e detit. Deri në 2030, synojmë trefishimin e eksporteve të acquakulturës.

Investojmë në teknologji inteligjente për monitorimin në kohë reale të fermave bujqësore dhe atyre peshkore, duke garantuar efikasitet dhe qëndrueshmëri.

Trefishojmë numrin e njësive agroturistike deri në 1,000 deri në vitin 2030, duke krijuar vende pune për gratë dhe të rinjtë.

2.7 Mbrojtja e Mjedisit dhe Energjia e Gjelbër – Shqipëria e së ardhmes së pastër dhe të qëndrueshme

Çfarë bëjmë së bashku?

Mbajtëm të pandryshuar çmimin e energjisë për konsumatorët familjarë dhe biznesin e vogël gjatë krizës globale energjitike, duke mbrojtur fuqinë blerëse të qytetarëve.

Për herë të parë pas 34 vitesh, mundësuam uljen me 10% të çmimit të energjisë elektrike, falë transformimit dhe rimëkëmbjes së sektorit energjitik përmes rritjes së kapaciteteve

prodhuese dhe menaxheriale. Nga kjo ulje përfitojnë 95% e konsumatorëve familjarë, duke nxitur edhe kursimin e energjisë.

Dyfishuam fuqinë prodhuese nga 1,768 megavat në 3,298 megavat.

Ulëm humbjet në shpërndarjen e energjisë elektrike nga 50% në më pak se 18%.

Mbështetëm vetëprodhimin e energjisë, duke rritur kapacitetin e instaluar në 197 MW për konsumatorët dhe bizneset që investojnë në panele diellore.

Nxitëm vetëprodhimin dhe efikasitetin energjitik, duke lehtësuar investimet në burime të rinovueshme për konsumatorët, zbatuar skemën e matjes neto, financuar 2,000 panele diellore për ngrohjen e ujit dhe rehabilituar energjetikisht 16 godina publike e rezidenciale.

Vumë në punë centralin fotovoltaik të Karavastasë me kapacitet 140 MW, investimi më i madh i këtij lloji në vend.

Shtuam 1,300 MW kapacitete të reja nga burime të rinovueshme, duke diversifikuar prodhimin dhe bën të mundur që 10% e energjisë sot të vijë nga fotovoltaikët.

Krijuam Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX) si dhe mundësuam forcimin e interkoneksioneve rajonale.

Shpallëm Vjosën si parku i parë kombëtar i një lumi të egër në Europë, siguroi mbrojtjen e plotë të saj dhe tre degëve kryesore (Bënça, Drino dhe Shushica), duke e vendosur Shqipërinë në hartën globale të mbrojtjes së mjedisit.

Zgjeruam zonat e mbrojtura në mbi 22% të territorit kombëtar, duke shpallur parqe të reja natyrore dhe rezerva që mbrojnë florën dhe faunën unike të Shqipërisë.

Në kuadër të fushatës “Shqipëria e Gjelbër”, mbollëm mbi 5 milionë pemë, duke krijuar hapësira të reja të gjelbra dhe përmirësuar cilësinë e ajrit në qytete dhe zona rurale.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Shqipëria 2030, një vend eksportues neto i energjisë elektrike në të gjithë rajonin.

6-fishojmë fuqinë prodhuese të energjisë, duke arritur 10,988 megavat deri në fund të mandatit të katërt, për një Shqipëri me më shumë energji të pastër dhe të sigurt.

Sistem energjetik të diversifikuar, ku mungesat nga thatësirat kompensohen me energji të pastër nga dielli dhe era. Synojmë që prodhimi fotovoltaiik të arrijë në 30% të totalit, duke garantuar siguri dhe qëndrueshmëri energjetike.

2-fishojmë prodhimin e energjisë së gjelbër jo-hidrike, duke shtuar 300 MË energji të pastër nga parqet fotovoltaike dhe ato eolike.

Reduktojmë humbjet e energjisë në rrjet në vetëm 10%, falë investimeve strategjike në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, duke përmirësuar efencën dhe sigurinë e furnizimit.

Efencë energjetike në ndërtesa dhe pajisje, përmes skemave të dedikuara të subvencionimit dhe zgjerimit të programeve për përdorimin e teknologjive me konsum të ulët energjie.

Gazifikimi i qytetit të Korçës për ta shtrirë më pas edhe në qytete të tjera të vendit si një alternativë për rritjen e sigurisë energjitike dhe diversifikimin e burimeve të furnizimit me energji.

Krijimi i ekonomisë qarkulluese, duke investuar në qendra moderne riciklimi dhe duke krijuar një sistem më të efektshëm të grumbullimit të mbetjeve në të gjitha bashkitë.

Angazhimi për një Shqipëri lider rajonal në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

2.8 Inovacioni dhe Teknologjia – Shqipëria Dixhitale e së Ardhmes

Çfarë bëme që bashku?

Mbështetëm startup-et dhe inovacionin, duke garantuar një fond prej 10 milionë euro për periudhën 2022–2025, duke synuar mbështetjen e 250 startup-eve.

Krijuam teknoparkun "Durana Tech Park", ku mbi 50 kompani vendase dhe të huaja kanë shprehur tashmë interesin për t'u regjistruar.

Krijuam një mjedis të favorshëm për nomadët dixhitalë dhe profesionistët e huaj, duke i lejuar ata të punojnë online për kompani ndërkombëtare nga Shqipëria.

Transformuam administratën publike përmes digjitalizimit të plotë të shërbimeve, duke rritur transparencën dhe aksesin për qytetarët dhe bizneset.

Po zhvillojmë "e-Albania 2.0, një platformë inovative e bazuar në modelin "life events", që ofron shërbime të personalizuara dhe asistencë të avancuar digjitale.

Futja e Inteligjencës Artificiale në administratë, ku asistentja digjitale "Diella" do të mund të përfundojë automatikisht procese të tëra shërbimesh për qytetarët.

Zgjeruam GovNet, rrjetin e sigurt të komunikimit mes institucioneve publike, dhe vendosëm Inteligjencën Artificiale në sektorin publik për të automatizuar prokurimet, analizuar të dhënat fiskale dhe forcuar luftën kundër evazionit fiskal.

Ndërtuam 340 laboratorë inteligjentë në shkolla, duke ofruar pajisje moderne për mësimin e teknologjisë. Brenda vitit 2026, do të kemi 985 laboratorë inteligjentë, duke garantuar që asnjë fëmijë të mos mbetet pa akses në teknologji.

Hapëm qendrën e inovacionit TUMO në Piramidën e Tiranës, ku mësojnë mbi 1,500 të rinj nga 12 deri në 18 vjeç falas.

Sollëm e "Plug and Play" në Shqipëri, një nga platformat më të mëdha të startup-eve në botë, e cila ndihmoi në krijimin e Google dhe dhjetëra kompanive "unicorn.

U hap "École 42", instituciont francez i teknologjisë, që do të formojë 250 programues të rinj çdo vit në Tiranë, pa kriter akademik, vetëm në bazë të talentit.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

3-fishojmë fondet për startup-et dhe krijojmë inkubatorë dhe akseleratorë të rinj për të fuqizuar sipërmarrësit e rinj.

Zgjerojmë teknoparqet në qytete të tjera të vendit, duke ofruar infrastrukturë dhe lehtësi fiskale për kompanitë teknologjike dhe bizneset inovative.

Krijojmë asistentin virtual për bizneset, i cili do të ndihmojë aksesin dhe integrimin e bizneseve shqiptare në tregun europian, duke ofruar: Akses në legjislacionin e BE-së për tregtinë dhe biznesin; Përgjigje mbi eksportet, hapjen e bizneseve, aplikimin në fondet e BE-së dhe mundësi të tjera.

Zhvillojmë asistentin virtual për administratën publike dhe bëjmë Shqipërinë lider në Evropë për përdorimin e AI në administratë, duke implementuar një model të zhvilluar nga

AKSHI në bashkëpunim me Microsoft, për të përshpejtuar procesin e integritit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në vetëm 2 vite, nga 7 vite që i është dashur vendeve të tjera.

Krijojmë Qendrën e Rezervimit të të Dhënave (Data Recovery Center) për të garantuar sigurinë e informacionit dhe qëndrueshmërinë e sistemeve elektronike.

Transformimi digjital nuk është më një ëndërr për Shqipërinë – është një realitet që po përshpejtohet çdo ditë. Brenda dekadës së ardhshme, vendi ynë do të jetë një model për inovacionin dhe teknologjinë në rajon dhe më gjerë. Shqipëria e së ardhmes është digjitale, e zhvilluar dhe e lidhur me botën!

③

Mirëqënie për të gjithë

Reformat e ndërmarra në fusha të rëndësishme si arsimi, shëndetësia, siguria, strehimi dhe mbrojtja sociale kanë hedhur themelet e një Shqipërie të re dhe të transformuar. Me këtë vizion, synojmë të ndërtojmë një shoqëri ku fëmijët dhe të rinjtë qëndrojnë në qendër të zhvillimit kombëtar; ku sistemi arsimor dhe shëndetësor të jenë garantues të një jete dinjitoze për të gjithë; ku familjet e reja të gjejnë mbështetjen e nevojshme për të realizuar ëndrrat dhe aspiratat e tyre; dhe ku siguria dhe drejtësia të mos jenë thjesht parime abstrakte, por realitete të prekshme në jetën e përditshme të çdo qytetari.

3.1 Fëmijët dhe të Rinjtë – Zemra e Shqipërisë së Ardhshme

Shqipëria ka një rini të talentuar, plot energji dhe potencial, por për shumë kohë ky potencial mbeti i pashfrytëzuar.

Arsimi vuante nga infrastruktura e dobët, pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje ishte simbolike dhe mundësitë për zhvillim personal e profesional ishin inekzistente. Pikërisht ky realitet na shtyu të ndërtojmë një Shqipëri të re, ku fëmijët dhe të rinjtë janë sot në qendër të çdo plani, politike dhe investimi.

Cfarë bëjmë së bashku?

Zhvilluam programe jashtëshkollore në arte, zeje dhe sporte në mbi 200 shkolla, duke përfshirë mijëra fëmijë në aktivitete artistike dhe zëjtari.

Vendosëm rininë si prioritet kombëtar duke mbështetur me financim 1,800 programues të rinj përmes akademive të kodimit dhe kurseve digjitale.

Ndërtuam 15 qendra rinore dhe biblioteka, ku mbi 230,000 të rinj kanë gjetur hapësira për mësim, bashkëpunim dhe krijimtari.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Risim pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, duke zgjeruar Këshillat Rinorë dhe platformat e përfshirjes në të gjithë vendin.

Forcojmë mbështetjen sociale dhe emocionale për fëmijët dhe të rinjtë, duke rritur aksesin në psikologë dhe punonjës socialë.

Ndërtojmë më shumë qendra rinore, duke i kthyer ato në hapësira për krijimtari, aftësim dhe ndërveprim komunitar.

3.2 Arsimi Çelësi për Shqipërinë e Zhvilluar

Një vend i zhvilluar nis me një sistem arsimor të fortë, që garanton mundësi të barabarta për çdo fëmijë. Për vite me radhë, arsimi u la pas dore: shkolla në gjendje të rrënuar, mungesë transparence dhe meritokracie, mësues të papërgatitur dhe një shkëputje e madhe nga tregu i punës.

Cfarë bëmë që bashku?

Siguroam transparencë dhe meritokraci në punësimin e mësuesve përmes portalit "Mësues për Shqipërinë", ku mbi 55,000 aplikantë kanë konkurruar me kriterë të barabarta.

Investuam në infrastrukturën arsimore, duke rikonstruktuar 450 shkolla dhe objekte sportive, duke përmirësuar kushtet për 250,000 nxënës dhe mësues.

Për të përgatitur fëmijët për epokën digjitale, 340 shkolla u pajisën me laboratorë SMART, ndërsa 16,000 mësues u trajnuan për zhvillim profesional.

2-fishuam pagën mesatare të mësuesve nga 420 euro në 950 euro, duke reflektuar vlerësimin për këtë profesion.

Lehtësuam barrën financiare për familjet shqiptare, duke ofruar transport falas për 38,000 nxënës dhe 12,000 mësues, tekste falas për 238,000 nxënës çdo vit, si dhe 2,100 mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të veçanta.

Angazhuam 850 psikologë dhe punonjës socialë për të mbështetur zhvillimin emocional dhe social të nxënësve.

Filluam zbatimin e sistemit dual në arsimin profesional, i cili kombinon mësimin teorik në shkollë me praktika profesionale në biznese dhe institucione, duke forcuar lidhjen midis tregut të punës dhe aftësimit profesional. 3-fishuam numrin e bizneseve që bashkëpunojnë me shkollat profesionale.

3-fishuam financimin për universitetet, duke e rritur nga 69 milionë euro në 200 milionë euro.

Realizuam për herë të parë procesin e akreditimit institucional të universiteteve publike dhe dyfishuam investimet në infrastrukturë dhe kërkim shkencor. Ndërkohë, laboratorët modernë dhe fondet për bursa mbështetën mbi 50,000 studentë çdo vit.

Çfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Risim pagën mesatare të mësuesit në 1,250 euro brenda mandatit të katërt dhe investojmë në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të punës për mësuesit.

Ndërtojmë 200 shkolla të reja dhe investojmë 60 milionë euro në rindërtimin dhe modernizimin e shkollave profesionale për të siguruar një infrastrukturë arsimore cilësore.

Krijojmë 1,000 laboratorë inteligjentë dhe pajisim çdo klasë me kamera inteligjente deri në vitin 2026 për të modernizuar procesin mësimor dhe garantuar një mjedis më të sigurt dhe inovativ për nxënësit.

Themelojmë shoqërinë publike të transportit shkollor falas.

2-fishojmë numrin e nxënësve në arsimin profesional, duke synuar që 35% e nxënësve të zgjedhin këtë rrugë edukimi.

Përfundojmë projektet madhore të Universitetit të Tiranës dhe Kolegjit të Evropës, duke forcuar arsimin e lartë dhe krijuar mundësi akademike të nivelit ndërkombëtar.

3.3 Shëndetësi për të gjithë

Në këto vite, kemi ndërmarrë një transformim rrënjësor të sistemit shëndetësor shqiptar. Sot, Shqipëria garanton mbulim universal shëndetësor për të gjithë qytetarët, pavarësisht nëse janë të siguruar apo jo.

Përmes një vizioni të qartë dhe investimeve të mëdha, transformuan spitalet dhe qendrat shëndetsore, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet e ofrimit të kujdesit shëndetësor.

Çfarë bëjmë së bashku?

3-fishuam buxhetin e shëndetësisë, nga 250 milionë euro në 760 milionë euro, duke forcuar cilësinë e shërbimeve në sistemin shëndetësor.

Siguroam shërbim shëndetësor falas për 600 mijë qytetarë të pasiguruar dhe dyfishuam fondin për barnat e rimbursueshme, duke shtuar 200 medikamente të reja në listë.

Ulëm çmimet e barnave me 30% krahasuar me vitin 2013 dhe garantuam rimbursim të plotë për 210 mijë pensionistë.

Rehabilituam 400 ambulanca dhe qendra shëndetësore, ndërtuam 53 spitale të reja (10 të rinj dhe 43 të rindërtuar) dhe krijuam një flotë me 320 autoambulanca të reja, duke siguruar kohë mbërritjeje jo më shumë se 15 minuta.

3-fishuam pagën mesatare të mjekëve, nga 490 euro në 1,670 euro, dhe pagën mesatare të infermierëve, nga 280 euro në 850 euro, duke rritur motivimin dhe cilësinë e shërbimit.

Çfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Në Shqipërinë 2030 të gjitha qendrat shëndetësore dhe ambulancat do të jenë plotësisht të rindërtuara.

Vazhdojmë programin e check-up falas për pensionistët dhe heqjen e limitit të moshës për përfituesit.

Gjatë mandatit të katërt, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” transformohet në qendrën më të mirë spitalore universitare të rajonit, që do të funksionojë në sinergji të plotë me Spitalin prestigjioz San Raffaele të Milanos dhe me Universitetin me të njëjtin emër. Kjo qendër do t’i ulë drastikisht ikjet e shqiptarëve jashtë vendit për të marrë një shërbim spitalor, si edhe do të rrisë prestigjin e Shqipërisë edhe si një destinacion shërbimi shëndetësor.

Aktivizojmë Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shëndetit (e-Shëndeti), që mundëson një sistem shërbimi më efikas dhe të integruar, si edhe zgjerojmë telemjekësinë për të ofruar kujdes mjekësor në distancë, veçanërisht për zonat rurale.

Zgjerojmë autonominë spitalore financiare, për të rritur investimet në pajisje, staf dhe infrastrukturë për një shërbim spitalor më të shpejtë dhe efektiv.

Intensifikojmë programet e parandalimit të sëmundjeve veçanërisht për kancerin dhe sëmundjet kardiovaskulare, duke investuar në qendra shëndetësore dhe laboratorike moderne të shtrira në territor.

3.4 Strehimi dhe Familjet e Reja – Shtylla e Shqipërisë së Nesërme

Cfarë bërmë jë bashku?

Që nga marrja e mandatit, 130 mijë qytetarë shqiptarë kanë përfituar nga 35 mijë njësi banimi, të shpërndara nëpërmjet disa programeve strategjike të strehimit:

Përmes Programit Kombëtar të Strehimit Social, mijëra familje në nevojë kanë siguruar një banesë të përballueshme, duke përfituar nga mbështetja e drejtpërdrejtë e shtetit.

Fondi Publik i Banesave Sociale është zgjeruar ndjeshëm, duke ofruar njësi të reja banimi për kategoritë që kanë më shumë nevojë për mbështetje në strehim.

Programi i Rindërtimit ka mundësuar ndërtimin dhe rikonstruksionin e mijëra njësive të reja banimi për familjet e prekura nga tërmeti i nëntorit 2019.

Programi i Kredive të Lehtësuara ka mbështetur punonjësit e administratës publike, përfshirë mësuesit, infermierët dhe punonjësit e sigurisë, duke i ndihmuar të sigurojnë një banesë me kushte të favorshme financiare.

Mbështetëm mijëra familje për riparimin ose rindërtimin e banesave të tyre përmes Skemave të Rindërtimit dhe Granteve të Strehimit, duke përmirësuar kushtet e jetesës dhe rikthyer stabilitetin e tyre.

Zgjeruam furnizimin me ujë 24 orë nga vetëm 4 zona urbane, në 43 zona urbane dhe 98 zona rurale.

Realizuam për herë të parë një program depistimi falas për fëmijët e moshës 6-15 vjeç, duke përfshirë kontrollin e shikimit dhe trajtimin dentar, ku vetëm në vitin 2024 u kryen 34,000 depistime për shikim dhe mbi 4,400 fëmijë u referuan për trajtime të mëtejshme.

Mbështetëm lindshmërinë me Programin Universal të Bonusit të Bebes, duke shpërndarë mbi 227,000 bonuse për familjet shqiptare duke shpërndarë mbi 145 milionë euro që nga viti 2019. Vetëm në vitin 2023, janë mbështetur 43,357 lindje.

Çfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Angazhimi për strehimin do të thellohet gjatë mandatit të katërt, me një investim prej 300 milionë euro për mbështetjen e çifteve të reja me kredi lehtësuese.

Investojmë për të siguruar furnizim me ujë 24 orë edhe në 16 zona të tjera urbane dhe 37 zona rurale. Në 2030 mbulojmë 100% të qyteteve dhe 80% të fshatit me ujë 24 orë.

Vazhdojmë të mbështesim familjet përmes programeve sociale të strehimit, duke siguruar që grupet më në nevojë të shoqërisë, të përfitojnë mbështetje prioritare.

Mbështesim familjet me të ardhura të ulëta përmes Entit Kombëtar të Banesave, duke zgjeruar mundësitë për strehim në disa bashki të vendit.

Zgjerojmë programin për administratën publike, duke përfshirë sektorë të tjerë të shoqërisë dhe duke ofruar mbështetje për më shumë familje.

Me Programin e ri “Një çati për çdo fëmijë”, do të mbështesim familjet me fëmijë minorenë për të blerë ose zgjeruar banesën e tyre deri në vitin 2030, duke i dhënë përparësi familjeve me fëmijë të vegjël.

Rrisim financimet për përmirësimin e banesave për shtresat më të varfra, duke siguruar standarde më të larta jetese për të gjithë.

Brenda mandatit të katërt në çdo bashki qendër qarku implementojmë programin e ushqimit në shkollë dhe krijojmë programin e ri pas-shkolle (after school).

3.5 Pensionet – Siguri dhe Dinjitet për Moshën e Tretë

Pensionet nuk janë thjesht një e drejtë, por një detyrim moral dhe ekonomik për një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Për vite me radhë, sistemi i pensioneve vuante nga mungesa e transparencës, defiçite të larta dhe një skemë rrënuese, që nuk garantonte një lidhje të drejtë midis kontributeve dhe përfitimeve. Burokracia e rëndë dhe dokumentacioni i paplotë e bënin procesin e përfitimit të pensioneve të vështirë për shumë qytetarë.

Çfarë bëjmë që bashku?

Transformuam sistemin e pensioneve, duke e bërë më transparent, të drejtë dhe financiarisht të qëndrueshëm.

Pensioni mesatar kur morëm detyrën ishte vetëm 86 euro, ndërkohë që në 2024 pensioni mesatar arriti vlerën 175 euro.

Reduktuam defiçitin e skemës së pensioneve nga 2% e PBB-së në 0.85% në 2024, duke garantuar qëndrueshmëri financiare dhe ulur presionin mbi buxhetin e shtetit.

Siguruam pension social për të gjithë qytetarët e moshës së tretë, duke garantuar mbulueshmëri 100% dhe duke eliminuar rrezikun që të moshuarit të mbeten pa mbështetje financiare.

Nga vetëm 2 marrëveshje që gjetëm, kemi nënshkruar 16 marrëveshje për njohjen e ndërsjelltë të pensioneve, duke garantuar të drejtat e mbi qindramijëra bashkëatdhetarëve tanë jashtë vendit.

Luftuam informalitetin, duke rritur deklarimin e pagave reale dhe duke siguruar më shumë të ardhura për skemën e pensioneve. Njohëm në mënyrë automatike periudhat e punës në ish-kooperativa dhe ndërmarrje shtetërore, duke adresuar padrejtësitë e së shkuarës për mijëra qytetarë.

Çfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Ambicia jonë është që në Shqipërinë 2030 pensioni mesatar të jetë 400 euro për ata që kanë paguar sigurime të plota, pensioni minimal për të gjithë të jetë 200 euro.

Përfundojmë nënshkrimin e marrëveshjes për njohjen e ndërsjelltë të pensioneve me Greqinë.

Vijojmë të indeksojmë rregullisht pensionet, duke i përshtatur me rritjen e kostos së jetesës dhe duke dhënë bonuse të veçanta sipas zhvillimeve ekonomike të vendit. Deri në vitin 2030, pensionet do të mbulojnë 40% të të ardhurave të fituara gjatë viteve të punës.

Ulim më tej informalitetin, duke nxitur deklarimin e pagave reale dhe siguruar që çdo punonjës të kontribuojë drejt pensionit të tij.

Krijojmë një sistem plotësisht elektronik për sigurimet shoqërore, duke mundësuar shërbime të shpejta dhe të aksesueshme për qytetarët në çdo moment.

3.6 Mbrojtja Sociale dhe Ndihma Sociale – Garantimi i Solidaritetit dhe Dinjitetit

Një shoqëri e drejtë matet nga kujdesi për më të dobët e saj. Për vite me radhë, sistemi i mbrojtjes sociale dhe ndihmës ekonomike vuante nga mungesa e transparencës dhe kritereve të qarta. Familjet në nevojë mbeteshin jashtë skemave mbështetëse, ndërsa vendimmarrja subjektive favorizonte abuzimet. Sistemi i ndihmës për personat me aftësi të kufizuara ishte i mbingarkuar dhe joefektiv, ndërsa shërbimet sociale bazë mungonin, duke lënë mijëra qytetarë pa mbështetjen që meritonin.

Cfarë bëme që bashku?

Ndërtuam një sistem mbrojtjeje sociale më të drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës.

Transformuam skemën e Ndhmës Ekonomike, duke përjashtuar 20,000 familje abuzuese dhe duke përfshirë 15,000 familje realisht në nevojë.

2-fishuam buxhetin e ndihmës ekonomike nga 3.5 miliardë lekë në 7.5 miliardë lekë, duke garantuar mbështetje për gratë kryefamiljare, viktimat e dhunës dhe fëmijët jetimë.

Subvencionuam kontributet për 9,200 nëna të papuna me tre ose më shumë fëmijë, duke ndihmuar familjet më të mëdha dhe më të ekspozuara ndaj vështirësive ekonomike.

Reformuam skemën për personat me aftësi të kufizuara, duke kaluar në një model modern sipas standardeve të OBSH, duke reduktuar burokracinë dhe dokumentacionin me 75%.

Zhvilluam rrjetin e shërbimeve sociale, duke krijuar Fondin Social, i cili ka financuar 84 shërbime të reja për 44,000 përfitues.

Ndërtuam Hartën Digjitale dhe Regjistrin Kombëtar të Shërbimeve Sociale, duke lehtësuar aksesin dhe përshpejtuar përfitimin e ndihmës për çdo qytetar.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Zgjerojmë përfshirjen dhe përmirësojmë cilësinë e shërbimeve sociale, duke siguruar mbështetje më të madhe për grupet më të cënueshme.

Rrisim me 20% numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike, me fokus gratë kryefamiljare dhe komunitetet rome e egjiptiane.

Thyejmë ciklin e varfërisë, duke rritur përfitimet për fëmijët e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike, për të nxitur arsimin dhe zhvillimin profesional.

Integrojmë përfitimet financiare me shërbime të personalizuar dhe krijojmë programe punësimi të dedikuara për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Ofrojmë asistencë shtëpiake dhe këshillim psiko-social për të moshuarit, duke garantuar dinjitet dhe përkujdesje afatgjatë.

Krijojmë 20 ndërmarrje sociale për të përfshirë gratë dhe komunitetet vulnerabël në zonat rurale.

Shtojmë 40 shërbime të reja, me fokus te fëmijët, gratë në risk dhe të moshuarit.

Krijojmë një program për ndihmë të shpejtë gjatë krizave natyrore dhe fatkeqësive, për të siguruar mbështetje të menjëhershme për kategoritë më vulnerabël.

3.7 Barazia Gjinore – Gurthemeli i një Shoqërie të Drejtë

Cfarë bëjmë së bashku?

Rritëm përfaqësimin e vajzave dhe grave në politikë e në drejtimin e institucioneve, duke ngritur atë në nivele historike. Nga vetëm 18% në Kuvend në vitin 2013, sot zënë 35.7% të vendeve parlamentare dhe 55% të kabinetit qeveritar, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet me përfaqësimin më të lartë të vajzave e grave në rajon.

Forcuam kuadrin ligjor për barazinë gjinore për të siguruar më shumë mekanizma për mbrojtjen nga dhuna për garantimin e të drejtave të grave në të gjitha bashkitë e vendit, duke ofruar mbrojtje të menjëhershme.

Zgjeruam shërbimet sociale për viktimat duke përfshirë një qendër kombëtare për viktimat e dhunës, dy qendra “one stop” për fëmijët viktimë të dhunës, 13 qendra emergjente për ndihmë të menjëhershme dhe 20 shërbime të reja sociale, si linja këshilluese dhe streha për gra dhe vajza.

Mbështetëm fuqizimin ekonomik të grave përmes programeve të mikrokreditimit, duke rritur përfshirjen e tyre në biznes nga 28% në 31.2%. Për më tepër, politika e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor ka siguruar që 10% e shpenzimeve publike të jenë të dedikuara për nisma që ndihmojnë barazinë gjinore.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Synojmë që gratë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në politikë dhe institucione, duke e ngritur kuotën në 50% dhe duke trajtuar përfaqësimin nën 30% si diskriminim gjinor.

Garantojmë arsimin cilësor dhe programe trajnimi për të nxitur zhvillimin e tyre profesional dhe ekonomik.

Përmirësojmë strategjitë për parandalimin dhe adresimin e dhunës, duke synuar një shoqëri të lirë nga çdo formë abuzimi deri në vitin 2030.

Zgjerojmë shërbimet e mbrojtjes sociale, duke përfshirë kujdesin shëndetësor universal, transfertat në para dhe shërbimet e komunitetit për gratë dhe vajzat në nevojë.

Krijojmë fonde të posaçme për të inkurajuar sipërmarrjet e grave dhe rrisim qasjen e tyre në financim dhe tregje.

3.8 Siguria Publike dhe Lufta Kundër Krimit – Themel i një Shoqërie të Qetë dhe të Drejtë

Çfarë bëme që bashku?

Në këto vite, kemi transformuar rrënjësisht sistemin e sigurisë publike, duke e kthyer Policinë e Shtetit në një institucion modern, të besueshëm dhe të përkushtuar për garantimin e sigurisë qytetare.

Vrasjet me dashje kanë pësuar një rënie prej 71.8% nga viti 2012, një tregues i qartë i përmirësimit të sigurisë publike.

Përgjysmuam aksidentet rrugore dhe ulëm aksidentet fatale nga 13 në 7 për 100 mijë banorë, ndërkohë që numri i automjeteve në qarkullim është dyfishuar.

Forcuam Policinë Kriminale me më shumë kompetenca dhe fleksibilitet për goditjen e grupeve kriminale, ndërsa ngritëm 21 databaza kombëtare për të rritur shpejtësinë dhe efikasitetin e hetimeve.

Lufta kundër pasurive të paligjshme ka qenë një tjetër sukses i rëndësishëm. Në vitin 2023, janë sekuestruar 23.4 milionë euro pasuri kriminale, një rritje e ndjeshme nga vetëm 1.2 milionë euro në vitin 2013.

Eliminuam kultivimin masiv të kanabisit, veçanërisht në Lazarat, dhe shndërruam Shqipërinë nga një vend problematik në model për monitorimin e territorit me dronë e sisteme inteligjente survejimi.

Forcuam bashkëpunimin me INTERPOL, EUROPOL dhe ENFAST, krijuam skuadra të përbashkëta hetimore dhe rritëm shkëmbimin e informacionit në kohë reale për goditjen e krimit ndërkufitar.

Rritëm pagat e Policisë së Shtetit me 57% dhe përmirësuam kushtet e punës, ndërsa reforma në Akademinë e Sigurisë po rikthen studimet e larta për oficerët dhe forcon bashkëpunimin me akademitë ndërkombëtare.

Vendosëm sistemin “e-Gates” në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës duke reduktuar kohën e pritjes dhe përmirësuar sigurinë kufitare.

Modernizuam sistemin e Gjendjes Civile për të garantuar saktësi dhe transparencë, duke përfshirë regjistrimin e 2.6 milionë adresave të standardizuara.

Çfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Avancojmë sigurinë publike përmes teknologjisë, modernizimit të strukturave policore dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Pajisim çdo qytetar me kartën e identitetit digjital brenda vitit 2026, për t'i hapur rrugë shërbimeve më të shpejta dhe më të sigurta.

Monitorojmë 12 qytetet qendër qarku me teknologji Brenda vitit 2026, për më shumë siguri dhe kontroll në kohë reale.

Krijojmë një shërbim policor më efikas dhe të besueshëm, duke forcuar rolin e tij në mbrojtjen e qytetarëve dhe duke ngritur Këshillat Vendorë për Sigurinë Publike në çdo bashki.

Investojmë në infrastrukturë dhe edukim, me qëllim uljen e aksidenteve dhe fataliteteve rrugore, duke forcuar rregullat dhe kontrollet për një transport më të sigurt.

Krijojmë Zyrën për Rikuperimin e Aseteve, e cila do të menaxhojë dhe do të vërë në funksion të komunitetit pasuritë e sekuestruara nga aktivitetet kriminale, duke kthyer burimet e paligjshme në kontribute për shoqërinë.

Akreditojmë shërbimet policore sipas standardeve ndërkombëtare ISO, duke garantuar një sistem sigurie të qëndrueshëm, transparent dhe të besueshëm.

Forcojmë masat për mbrojtjen e pushuesve dhe menaxhimin e hapësirave bregdetare dhe ujore, duke garantuar sigurinë në sezonin turistik dhe një administrim më të mirë të territorit.

3.9 Sporti – Forca e Shqipërisë së Shëndetshme dhe të Bashkuar

Çfarë bëjmë së bashku?

Në një dekadë, sporti në Shqipëri është transformuar nga një sektor i lënë pas dore në një shtyllë kyçe të zhvillimit social dhe shëndetësor.

Përmes investimeve strategjike në infrastrukturë, kemi ndërtuar dhe rikonstruktuar 150 terrene sportive në shkolla dhe komunitete, duke krijuar hapësira moderne për aktivitete fizike dhe rekreative.

Stadiumet ndërkombëtare si "Air Albania," "Elbasan Arena," dhe impiantet sportive në Shkodër e Kukës tashmë plotësojnë standardet e FIFA-s dhe UEFA-s, duke u shndërruar në qendra të krenarisë kombëtare dhe promovimit ndërkombëtar.

Zhvilluam infrastrukturën sportive në të gjithë territorin e vendit, duke ndërtuar mbi 200 terrene sportive dhe palestra të reja në shkolla.

Krijuam programin "Ekipet Sportive në Shkollë" duke përfshirë mbi 12,000 të rinj dhe krijuar një kulturë të qëndrueshme sportive në sistemin arsimor.

Themeluam Akademinë e Futbollit 'Dyrrah City' në partneritet me Manchester City, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e talenteve.

Ndërsa sportistët tanë kanë ngritur flamurin kuqez në garat më prestigjioze, ne 3-fishuam financimet për sportin dhe shpërblyem sportistët e trajnerët me bonuse dinjitoze.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Ndërtojmë 4 stadione të reja në Tiranë, Durrës, Korçë dhe Vlorë, duke zgjeruar kapacitetin e infrastrukturës sportive kombëtare dhe krijojmë kushte të standardizuara për sportin profesionist.

Themelojmë akademi sportive sipas modeleve më të mira ndërkombëtare, si ato të NBA-së dhe Rafael Nadal, për të promovuar sportistë të rinj të talentuar dhe për të ngritur cilësinë e garave elitare.

Zgjerojmë ekipet sportive dhe disiplinat e reja në programet arsimore, duke forcuar edukimin fizik dhe pjesëmarrjen masive në sport.

Investojmë në ndërtimin e palestrave të reja dhe të më shumë terreneve sportive, duke krijuar një bazë të fortë për sportin në të gjitha nivelet.

Rrisim mbështetjen për sportistët elitare dhe federatat sportive me qëllim përgatitjen e brezit të ardhshëm në garat ndërkombëtare.

Ndërtojmë qendra olimpike moderne, duke garantuar kushte optimale për trajnim dhe konkurrencë në nivelet më të larta.

Krijojmë infrastrukturë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara, duke mundësuar përfaqësimin e Shqipërisë në Olimpiadat Speciale dhe Paraolimpiket.

3.10 Kultura – Rrënjët e Identitetit dhe Zhvillimit Kombëtar

Cfarë bëjmë së bashku?

E kthjem kulturën në një prioritet kombëtar me investime të qëndrueshme, duke transformuar trashëgiminë kulturore, infrastrukturën artistike dhe jetën kulturore në çdo cep të Shqipërisë.

Realizuar 650 restaurime në objekte të trashëgimisë kulturore, rijetëzuar 7 qendra historike. Sot Pazari i Ri në Tiranë, Kruja, Gjirokastra, Vlorë, Berati dhe Korça janë sot shembulli më domethënës i kësaj rilindjeje kulturore.

Rindërtuar 10 teatro dhe 20 muze, ndërsa rikonstrukcioni i Teatrit Kombëtar të Operës, ndërtimi i Arturbina-s dhe modernizimi i Galerisë Kombëtare kanë hapur një epokë të re për artin skenik dhe pamor.

Trashëgimia shqiptare është vlerësuar dhe njohur botërisht, me përfshirjen e Xhubletës, Kërcimit të Tropojës dhe Transhumancës në listën e UNESCO-s, duke forcuar ndjeshëm identitetin tonë kulturor.

Rritëm me 60% pagat për artistët në institucionet publike dhe financuar mbi 1,800 projekte të skenës së pavarur.

Javët Kulturore Ndërkombëtare e kanë kthyer Shqipërinë në një qendër të rëndësishme kulturore në rajon, duke sjellë diversitet artistik nga e gjithë bota dhe duke promovuar kulturën shqiptare jashtë kufijve.

Cfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Shqipëria e së ardhmes, një vend ku kultura zë një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Vijojmë investimet për të ngritur hapësira të reja, për të ruajtur trashëgiminë dhe për t'i dhënë artit e historisë shqiptare vlerësimin që meriton.

Ndërtojmë Teatrin e ri Kombëtar, një hapësirë moderne për artin skenik shqiptar, ndërkohë që restaurojmë Muzeun Historik Kombëtar dhe krijojmë muze të rinj, si Muzeu Hebraik në Vlorë, Muzeu Besa në Tiranë dhe Muzeu i Filmit.

Rikualifikojmë të gjitha destinacionet kulturore e historike, përmirësojmë infrastrukturën e tyre, trajnimin e personelit dhe menaxhimin e siteve, duke krijuar një model ekonomik të qëndrueshëm që përfiton nga rritja e vizitorëve dhe turizmit kulturor.

Krijojmë 10 hapësira të reja kulturore të dedikuara librit dhe artit deri në 2030, si dhe zhvillojmë programe të reja për edukimin kulturor në shkolla dhe universitete, për të forcuar lidhjen e brezit të ri me historinë dhe identitetin tonë.

Ngremë Qendrat Kulturore Shqiptare në Itali, Greqi, Francë, Gjermani, Angli e SHBA, për të promovuar kulturën shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Digjitalizojmë arkivat dhe trashëgiminë kulturore, duke krijuar platforma të hapura online për publikun dhe studiuesit, që pasuria jonë kulturore të jetë më e aksesueshme dhe moderne.





ps.al